



# LIRIA E MEDIAVE NË SHQIPËRI

## Raporti Hije 2024

*Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (Center Science and Innovation for Development – SCiDEV)*

*OBC Transeuropa (OBCT)*

---

Korrik 2024





Autorë:

Blerjana Bino, Drejtor Ekzekutiv, SCiDEV

Dea Elmasllari, Koordinator Projekti, SCiDEV

Massimo Moratti, Bashkëpunëtor Kërkimor i Lartë, OBCT

Serena Epis, Redaktore dhe Kërkuese, OBCT

## Liria e mediave në Shqipëri: Raporti Hije 2024

<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Liria e mediave në Shqipëri: Kontributi për Raportin e BE-së për Shtetin Ligjor</b>	<b>6</b>
2.1 Kërcënimet ndaj pluralizmit të mediave dhe profesionit të gazetarit	6
2.2 Aksesit në informacion	8
2.3. Mbrojtja e gazetarëve, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të gazetareve gra apo gazetarëve që i përkasin pakicave	10
2.4 Progresi në fushën e lirisë së mediave	13
2.5 Udhërrëfyesit si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE	14
<b>Rekomandime</b>	<b>15</b>
3.1 Sfidat strukturore	15
3.2 Cilësia e mediave në përgjithësi	15
3.3 Siguria e gazetarëve	16
3.4 Aksesit në informacion	18
3.5 Paditë gjyqësore kundër gazetarëve	18
3.6 Fushatat e shpifjes	18
3.7 Udhërrëfyesit për anëtarësimin në BE	19

## Hyrje

Për vendet që synojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian (BE), të tilla si Shqipëria dhe vendet e tjera kandidate nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, forcimi i medias së pavarur është thelbësor për konsolidimin e institucioneve demokratike dhe për ecurinë në negociatat për anëtarësimin në BE dhe reformat përkatëse.

Indekse dhe instrumente të ndryshme monitorimi (Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit) tregojnë për një situatë mjaft shqetësuese të lirisë së mediave në vend: në gjysmën e parë të vitit 2024, në Platformën “Harta e Lirisë së Mediave” (Mapping Media Freedom) janë regjistruar 20 raste shkeljesh të lirisë së shtypit dhe medias, ku preken 22 gazetarë dhe/ose profesionistë të mediave në Shqipëri, përfshirë këtu 9 raste sulmesh verbale, 4 raste sulmesh fizike, 1 incident ligjor, 5 raste censurimi dhe 2 sulme ndaj pronës. Kapja e medias nga pushtetet politike, paqëndrueshmëria financiare dhe standardet e dobëta etike janë vetëm disa nga elementët që karakterizojnë peizazhin mediatik shqiptar dhe e bëjnë atë tejet alarmant.

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria është subjekt i shqyrtimit çdo vit të procesit të reformës: në raportin e tij vjetor, Komisioni Evropian vlerëson nivelin e përgatitjes dhe përafrimin me standardet evropiane, përfshirë ato për lirinë e mediave, të cilat mbulohen kryesisht nga Kapitulli 23 i Acquis Communautaire për Gjqësorin dhe të Drejtat Themelore.

Përveç raporteve vjetore, duke filluar që nga ky vit, Shqipëria dhe të gjitha vendet e tjera kandidate do të përfshihen në publikimin e raporteve vjetore për shtetin ligjor, një mekanizëm i prezantuar për herë të parë në vitin 2020 i krijuar për monitorimin e zhvillimeve me sundimin e ligjit dhe rreziqet e mundshme tek të gjithë shtetet anëtare. Raportet e Komisionit për Shtetin Ligjor mbulojnë katër fusha kryesore: 1. Sistemi i drejtësisë; 2. Korniza kundër korrupsionit; 3. Liria dhe Pluralizmi i Mediave; 4. Çështjet institucionale që lidhen me pavarësinë e pushteteve (kontrollet dhe balancat). Që nga viti 2023, krahas raporteve, Komisioni Evropian u ka ofruar shteteve anëtare rekomandime, me anë të së cilave u bën thirrje

autoriteteve kompetente të trajtojnë dhe zgjidhin menjëherë problemet e mundshme të identifikuara në raportet e tij.

Kështu, Raportet e Shtetit Ligjor për vendet candidate - të cilat pritet të publikohen në korrik të vitit 2024 - do të plotësojnë dhe informojnë raportet vjetore tradicionale që Komisioni Evropian publikon zakonisht në fund të çdo viti.

Si pjesë e konsultimeve të Komisionit Evropian për Raportin e Shtetit Ligjor për Shqipërinë, ky Raport Hije ofron një analizë të përditësuar të peizazhit mediatik në Shqipëri, duke vënë në dukje hapat pozitivë përpara dhe mbi të gjitha sfidat e vjetra dhe të reja që duhen trajtuar. Analiza plotësohet me disa rekomandime të hollësishme që u drejtohen autoriteteve kombëtare dhe aktorëve përkatës të BE-së, duke i bërë thirrje atyre të ndërmarrin veprime dhe të forcojnë angazhimin e tyre në mbrojtje të lirisë së mediave në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

## Liria e mediave në Shqipëri: Kontributi për Raportin e BE-së për Shtetin Ligjor

### *2.1 Kërcënimet ndaj pluralizmit të mediave dhe profesionit të gazetarit*

Sfidat ndaj lirisë së mediave në Shqipëri janë kryesisht strukturore për nga natyra. Ekosistemi i mediave karakterizohet nga një marrëdhënie simbiotike mes interesave të fuqishme ekonomike dhe politike, në të cilat me raste mund të përfshihet edhe krimi i organizuar. Në Raportin e Treguesve për Sigurinë e Gazetarëve 2022 dhe në raportin e ardhshëm për Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve 2023 jepet një përshkrim i hollësishëm për këtë çështje.

Pavarësisht nga rritja e numrit të organeve të mediave, pronësia e mediave është shumë e përqendruar tek një numër i vogël individësh ose grupesh mediatike familjare. Këta pronarë i përdorin mediat shpesh si mjet për të ushtruar ndikim politik dhe ekonomik, duke ushtruar kontroll të fortë mbi raportimin, linjën editoriale dhe përcaktimin e agjendës. (Më shumë detaje mund të gjenden në MOMA 2023).

Cilësia e përmbajtjes së mediave është përkeqësuar, ku kemi rritje të autocensurës të gazetarëve dhe ngushtimin e hapësirës për gazetari të pavarur, kritike dhe investigative për shkak të çështjeve strukturore, kushteve të punës dhe presioneve. Praktika e përdorimit të mediave për shantazh rrezikon të bëhet normë. Kaosi informativ me çështje të tilla si lajmet e rreme, gjuha e urrejtjes, disinformimi, teoritë e konspiracionit dhe propaganda përkeqëson peizazhin e përgjithshëm mediatik në Shqipëri. (Për më shumë shih Raportin e Treguesve të Sigurt të Gazetarëve 2022 dhe Vibrant Information Barometer 2023).

Për sa i përket sigurisë së gazetarëve, sulmet aktuale ndaj sigurisë fizike dhe jetës së gazetarëve dhe të afërmeve të tyre mbeten të kufizuara në Shqipëri, siç monitorohet dhe raportohet rregullisht nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network). Rrjeti i Sigurt i Gazetarëve me mbështetjen e SCiDEV në vend ka regjistruar dhe raportuar 18 sulme kundër gazetarëve në

vitin 2022, 24 raste në vitin 2023 dhe 19 raste nga janari deri në korrik 2024. Në Shqipëri, mungojnë mbledhja dhe publikimi i të dhënave zyrtare për sulme të caktuara ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimi. Institucioneve shtetërore shpesh u mungojnë burimet dhe kapaciteti për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla, gjë që pengon përpjekjet për trajtimin e kësaj çështjeje. Megjithatë, Platformë e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve (Council of Europe Platform for the Safety of Journalists), Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Mediave (Rapid Media Freedom Response), dhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network) janë mekanizma të rëndësishëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve në Shqipëri. Këto organizata ofrojnë njoftime dhe raporte të rregullta, të cilave autoritetet shtetërore u përgjigjen. Megjithatë, mungesa e protokolleve të institucionalizuara dhe në sistem si dhe e mekanizmave për mbledhjen e të dhënave në Shqipëri mbetet një sfidë kryesore për garantimin e sigurisë së gazetarëve dhe trajtimin e sulmeve kundër tyre. (Për më shumë informacion për këtë shihni këtu dhe këtu).

Raportet nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt për sigurinë e gazetarëve në Shqipëri tregojnë se gjatë pesë viteve të fundit ka pasur raste të rënda të sulmeve fizike ndaj gazetarëve, të cilat nuk janë hetuar me seriozitetin e duhur. Mungesa e dispozitave të qarta në Kodin Penal që u garantojnë gazetarëve mbrojtje të posaçme kundër rasteve të dhunës apo sulmeve të kryera ndaj tyre për shkak të detyrës së tyre ka krijuar një mjedis ku prokurorët janë më pak të prirur t'i japin përparësi hetimit të këtyre krimeve. (Për më shumë në lidhje me procesin e rregullt shih Raport përshkrues për Shqipërinë - Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, publikuar në 2023).

Institucionet shtetërore në Shqipëri nuk kanë krijuar ende mekanizma efektivë të posaçëm për t'u siguruar masa mbrojtëse gazetarëve dhe stafit të mediave në rast kërcënimi. Gazetarëve nuk u ofrohet asnjë shërbim ligjor i specializuar. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në punën dhe jetën e tyre të përditshme. Mekanizmat e parashikuar në ligj për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave nuk janë të përshtatur për gazetarët dhe viktimat mund të mos përfitojnë mbrojtje të mjaftueshme apo ndonjë alternativë tjetër për transferimin e tyre brenda vendit. (Për më shumë në lidhje me procesin e rregullt shih Raport përshkrues për Shqipërinë - Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, publikuar në 2023 dhe këtu).

Për sa i përket kushteve të punës dhe të drejtave në punë, siguria e gazetarëve kërcënohet nga mangësitë në zbatimin e Kodit të Punës, nga sfidat gjinore në sektorin e medias, nga shqetësimet për sigurinë dixhitale, disinformimi me motive gjinore, ndjesitë në përgjithësi kundër mediave dhe presioni ndaj tyre. Gazetarët që punojnë në mediat lokale, gazetarët e rinj dhe gazetaret gra hasin në më shumë sfida. (Për më shumë shih Raportin e Treguesve për Sigurinë e Gazetarëve 2022.) Kushtet e punës së gazetarëve dhe siguria ekonomike janë të mjerueshme. Në vitin 2023, punonjës të mediave kanë depozituar në Inspektoratin Shtetëror të Punës 26 ankesa nga ndaj 5 subjekteve, kryesisht për shkelje si pagat e papaguara, mospagimin e orëve jashtë orarit dhe të pushimeve vjetore, krahas problematikave që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të ankesave, përfshirë këtu ato nga punonjësit e transmetuesit publik, shumë gazetarë dhe punonjës të mediave hezitojnë të paraqiten vetë për shkak të frikës nga pasojat, kufizimeve të burimeve dhe frikës për mundësitë e punësimit në të ardhshmen. (Këtu, këtu dhe këtu mund të gjeni më shumë informacion.)

## *2.2 Aksesi në informacion*

Ligji Nr. 119/2014 parashikon kërkesa për transparencë nga autoritetet publike si dhe dispozita për të drejtën e informimit. Ligji përcakton edhe Komisionerin për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoritetin përgjegjës për monitorimin e respektimit të ligjit dhe vendosjen e sanksioneve ndaj autoriteteve publike që refuzojnë pa arsye të japin informacionin e kërkuar. Gjithsesi, autoritetet publike mund të mos japin informacione që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, sekretet tregtare, privatësinë, të drejtën e autorit, politikat fiskale, hetimet e vazhdueshme penale ose administrative dhe konsultimet ndërqeveritare. Mungesa e një përkufizimi të qartë të dispozitës së "interesit publik" u jep institucioneve publike liri të konsiderueshme për të kufizuar apo refuzuar ligjërisht dhënien e informacionit. (Për më shumë shih Raportin e Treguesve për Sigurinë e Gazetarëve 2022.)

Vlen për t'u theksuar se gazetarët në Shqipëri janë përballur me sfida në marrjen e informacionit, veçanërisht në rastet kur informacioni i kërkuar ka të bëjë me zyrtarë të nivelit të lartë apo me tema të ndjeshme (Raporti për të Drejtën e Informimit 2023 dhe Konferenca e Reporterëve pa Kufij për të Drejtën e Informimit në Tiranë). Edhe pse ligji përcakton një kornizë për



marrjen e informacionit, mangësitë në zbatimin e tij dhe mundësia e fshehjes së informacionit me anë të dispozitave të përgjithshme mund të bëhen pengesë që gazetarët të marrin informacionin e kërkuar. Po ashtu, siguria e gazetarëve dhe mbrojtja e burimeve të tyre mund të jetë në rrezik kur hetohen çështje të ndjeshme. (Më shumë informacion gjendet këtu).

Aksesi në informacion është i kufizuar për shkak të mungesës së vullnetit politik, kulturës së përhapur të fshehtësisë nga ana e autoritetet publike dhe masave të dobëta të llogaridhënies dhe transparencës. Ndikimi i këtyre kufizimeve është veçanërisht i madh në gazetarinë investigative, e cila luan një rol vendimtar në zbulimin e korrupsionit dhe promovimin e llogaridhënies së qeverisë. Për shembull, ndryshimet në Ligjin për të Drejtën e Informimit në vitin 2023 u kritikuan për mostrajtimin e plotë të kërkesave të organizatave të mediave dhe grupeve të shoqërisë civile. (Për shembull, një nga kritikantët lidhet me faktin se vendimet e Komisionerit nuk përbëjnë titull ekzekutiv.) Autoritetet publike, përfshirë institucionet e reja të drejtësisë, janë përpjekur të prezantojnë rregullore edhe për akreditimin e mediave duke kufizuar kështu aftësinë e gazetarëve për të marrë informacione.

Për sa i përket aksesit në informacion, Zyra e Komisionerit ka shqyrtuar 957 ankesa gjatë vitit 2023, rreth 390 prej të cilave janë paraqitur nga gazetarë dhe 170 nga organizata të shoqërisë civile. Kjo nxjerr në pah sfidat e vazhdueshme për transparencë dhe marrjen e informacionit (Raporti i KDIMDHP).

Përqendrimi i informacionit publik vazhdoi edhe në vitin 2023, që u përkeqësua nga përpjekjet intensive të propagandës së qeverisë, nga fushatat e disinformimit nga grupet e opozitës, ndërkohë që përpjekjet sistematike të aktorëve politikë në nivel vendor dhe qendror për të zëvendësuar gazetarinë e mirëfilltë me përmbajtje mediatike të parapërgatitur. Kanë dëmtuar rëndë kapacitetin e mediave profesionale për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe të saktë. Kjo prirje tejet shqetësuese ka rezultuar në një peizazh mediatik shumë të centralizuar të dominuar nga një gamë e ngushtë këndvështrimesh dhe perspektivash. Ajo ka gërryer larminë e zërave që janë të nevojshëm për një demokraci të shëndetshme.

### *2.3. Mbrojtja e gazetarëve, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të gazetareve gra apo gazetarëve që i përkasin pakicave*

- Në vitin 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dokumentoi 24 raste të sulmeve kundër gazetarëve dhe profesionistëve të medias, 9 prej të cilave ishin sulme të drejtpërdrejta ndaj disa gazetarëve apo grupeve të profesionistëve të mediave. Gjatë vitit 2024, në periudhën janar-korrik janë regjistruar 19 raste.
- Ka një mospërputhje të dukshme në numrin e raportuar nga institucionet me atë të policisë që raporton 5 raste sulmesh në vitin 2023 dhe prokuroria që raporton 7 raste. Kjo mospërputhje nënvizon nevojën për regjistrim dhe publikim sistematik dhe të saktë të të dhënave për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias si nga policia ashtu edhe prokuroria.
- Në vitin 2024, sulmet kibernetike nxorën në pah sfida të mëdha për mediat e pavarura (rasti i Citizens), duke theksuar domosdoshmërinë që agjencitë e zbatimit të ligjit të pajisen me burime të mjaftueshme për të adresuar numrin në rritje të këtyre incidenteve që kanë si objektiv gazetarët si dhe qytetarët në përgjithësi. Figurat politike urdhërojnë kryesisht sulme kundër mediave kritike, investigative ose gazetarëve të pavarur (për shembull, rasti i Ola Xamas, dhe rasti i BIRN).
- Numri aktual i incidenteve ka të ngjarë të tejkalojë numrin e rasteve të dokumentuara, duke theksuar rëndësinë e fuqizimit të gazetarëve në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e tyre. Në mungesë të sindikatave apo shoqatave të konsoliduara të gazetarëve me burime dhe kapacitetin e nevojshëm për të mbrojtur dhe mbështetur gazetarët, grupet informale, mbështetja dhe solidariteti mes kolegëve, si dhe advokimi marrin një rëndësi përherë e më të madhe. Nga ana tjetër, angazhimi i shoqërisë civile dhe i sektorëve të tjerë, si qarqet akademike, është jetik për nxitjen e kulturës së tolerancës zero ndaj frikësimit dhe kërcënimit të gazetarëve.
- Gazetaret gra në Shqipëri vazhdojnë të raportojnë raste të ngacmimeve seksuale, dhunës online dhe fushatave të shpifjes si format më të zakonshme të presioneve me bazë gjinore me të cilat përballen ato. Këto presione shpesh nuk raportohen, ku shumë gazetare mendojnë se ankesat e tyre nuk do të merren seriozisht ose gazetaret do të përballen me hakmarrje në rast se denoncojnë. Për më

tepër, ka shqetësime në rritje për disinformimin me bazë gjinore dhe për dhunën online ndaj gazetareve gra. Këto të fundit kanë raportuar se janë përballur me një nivel më të madh komentesh mizogjene dhe kërcënuese në platformat e mediave sociale, ku disa komente janë haptazi të dhunshme ose seksuale për nga natyra. Ky lloj ngacmimi dhe disinformimi online mund të dëmtojë në mënyrë të veçantë karrierën e grave, pasi mund t'i dekurajojë ato në mbulimin e një historie të caktuara ose në marrjen përsipër të roleve të caktuara në sektorin e medias. (Për më shumë shih Raportin e Treguesve për Sigurinë e Gazetarëve.)

- Rritja e rasteve të kërcënimeve dhe presioneve nga aktorë politikë dhe rritja e numrit të padive gjyqësore ndaj gazetarëve gjatë vitit 2023. Të dhënat e mbledhura nga SCiDEV përmes kërkesave zyrtare për informacion tregojnë një rritje të numrit të padive ndaj gazetarëve gjatë gjithë vitit 2023: Gjykata e Lartë ka trajtuar dy çështje, një penale dhe një administrative. Gjykata e Apelit shqyrtoi 28 çështje, ku 21 ishin civile dhe 7 penale. Në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë hapur 38 padi civile kundër gazetarëve dhe punonjësve të medias. Po ashtu, janë pesë padi civile të ngritura në gjykata si në Elbasan, Gjirokastër, Durrës dhe Lezhë, por pa raportime për raste të tilla në gjykata të tjera gjatë vitit. Në Shqipëri mungon një regjistër elektronik i specializuar për çështjet që kanë të bëjnë me gazetarët, ndonëse sistemi aktual i Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë e lejon një kategorizim të tillë, siç shpjegohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
- Prandaj, është e rëndësishme që Shqipëria të miratojë dekriminalizimin e plotë të shpifjes në mbrojtje të lirisë e shprehjes në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, përcaktimin e një përkufizimi të qartë ligjor lidhur me Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) në vijim edhe të miratimit nga Parlamenti Evropian i direktivës SLAPP në fillim të vitit 2024, dhe krijimin e një baze të dhënash të posaçme për të monitoruar dhe analizuar sistematikisht rastet që kanë të bëjnë me gazetarët dhe punonjësit e medias, duke synuar rritjen e mbrojtjes së tyre dhe zhvillimin e strategjive më efektive të reagimit.
- Sa i përket të dhënave personale, ka pasur një rast serioz lidhur me keqpërdorimin e të dhënave personale të gazetarëve të raportuar tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe të Drejtën e Informimit.

- Sfidat në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve:
- Nuk ofrohet ndihmë juridike falas: gazetarëve në Shqipëri u mungon akses i ndihmës juridike falas, e cila është me rëndësi të madhe për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe trajtimin e sfidave ligjore që lidhen me punën e tyre. Mediat zakonisht i lënë pa përkrahje dhe refuzojnë të ofrojnë mbështetje financiare ose ligjore në raste sulmesh. Pa këtë mbështetje, gazetarët gjenden të vetëm në përballjen me betejat ligjore, duke çuar potencialisht në censurë ose autocensurë.
- Akses i kufizuar të mekanizmat e mbrojtjes: Mungesa e mekanizmave efikase të mbrojtjes i lë gazetarët të pambrojtur përballë kërcënimeve dhe dhunës. Pa masa të besueshme mbrojtjeje, ata janë në një rrezik edhe më të madh kur raportojnë për çështje të ndjeshme ose të debatueshme.
- Frika nga hakmarrja: Gazetarët kanë frikë nga hakmarrja në rast raportimi tek autoritetet ose në publik të sulmeve ndaj tyre. Kjo frikë mund të vijë nga shqetësimet se ankesat e tyre mund të mos merren seriozisht ose mund të çojnë në rritje të agresionit nga autorët, të cilët mund të kenë lidhje të forta ose të jenë me pushtet. Ky shqetësim mund t'i dekurajojë gazetarët të kërkojnë drejtësi ose mbrojtje, duke i lënë ata potencialisht më të cenueshëm dhe duke minuar përpjekjet për të garantuar sigurinë e tyre dhe për të mbështetur lirinë e shtypit.
- Mosbesimi tek institucionet dhe proceset: Mungesa e besimit tek institucionet dhe proceset mund të jetë rrjedhojë e një historie rastesh të pazgjidhura ku përfshihen gazetarë dhe të perceptimeve për paragjykime ose mungesë efikasiteti në sistemin ligjor.
- Frika nga riviktimizimi: Gazetarët që janë përballur më parë me ngacmime ose dhunë mund të kenë frikë se do të bëhen sërish viktime, veçanërisht nëse përvojat e tyre të para nuk janë trajtuar në mënyrën e duhur.
- Sfidat të veçanta në raste fushatash shpifjeje:
- Gazetarët shqiptarë të shënjestruar nga fushatat e shpifjeve përballen me dëmtimin e reputacionit të tyre profesional, gjë që mund të çojë në mosbesim nga publiku dhe mundësisht minimin e punës së tyre gazetareske.

- Ndikimi i një fushate shpifjeje, ku sistemet mbështetëse mund të jenë disi të dobëta si në Shqipëri, ka një ndikim të madh psikologjik te gazetarët.
- Në Shqipëri, ku burimet për gazetarinë e pavarur janë më të kufizuara, përballja me fushata shpifjeje mund të çojë në devijim të përpjekjeve dhe fondeve që janë të rëndësishme për gazetarinë investigative.
- Autocensura dhe efekti vetëcensurues: Vëzhgimi i fushatave shpifëse mund të ngjall një ndjenjë frike mes gazetarëve të tjerë shqiptarë, duke çuar në autocensurë për të mos u bërë vetë objektiv sulmi.
- Përballja ligjore me fushatat e shpifjeve në Shqipëri është tejet sfiduese, duke pasur parasysh perceptimet për sistemin gjyqësor si jo të paanshëm, numrin jashtëzakonisht të madh të rasteve në pritje për gjykim dhe kostot e larta që lidhen me mbrojtjen ligjore.
- Gazetarët që janë viktimë të fushatave të shpifjeve në Shqipëri jo gjithmonë marrin solidaritet dhe mbështetje nga kolegët dhe komuniteti i tyre, duke përkeqësuar kështu efektet e fushatës dhe duke çuar ndoshta edhe në humbjen e burimeve dhe kontakteve të vlefshme.
- Avokati i Popullit, Komisioneri kundër Diskriminimit, Autoriteti i Mediave: – kompetenca/reagime të kufizuara.
- Rrjetet e solidaritetit dhe të mbështetjes janë të kufizuara.

#### *2.4 Progresi në fushën e lirisë së mediave*

Ndryshimet në Ligjin Nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, synojnë transpozimin e Direktivës (BE) 2018/1808 me qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me nevoja të veçanta, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, përforcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë. Në këto ndryshime ligjore trajtohen edhe koncepte të reja si bashkërregullimi, vetërregullimi dhe edukimi mediatik.

Po ashtu, në vitin 2023, pesë vjet pas zbatimit të tij, Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi një Kod të ri Transmetimi Audiovizual me qëllim përmirësimin e dispozitave që lidhen me barazinë gjinore, për trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe për luftën kundër disinformimit. Ky proces rishikimi është kryer në konsultim me shoqërinë civile, organizatat e medias dhe donatorët ndërkombëtarë.

Në aspektin pozitiv, janë bërë disa përpjekje për të krijuar rrjete të gazetarëve të rinj apo gazetarëve gra në media dhe për një shoqatë të gazetarëve të rinj për të lobuar për të drejtat dhe sigurinë në punë të gazetarëve.

### *2.5 Udhërrëfyesit si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE*

Në nëntor 2023, SCiDEV dha kontributin e saj në konsultimin e Udhërrëfyesit për “Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. SCiDEV bëri thirrje për krijimin e një kuadri kombëtar gjithëpërfshirës që ka në fokus pikërisht garantimin e sigurisë së gazetarëve, dhe që trajton ndërgjegjësimin, parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale, me vëmendje të veçantë tek dobësitë unike të gazetarëve gra dhe nevojës për masa të forta mbrojtëse për gazetarët në sferën dixhitale që përballet me rrezikun në rritje të kërcënimeve dhe mbikëqyrjes kibernetike.

Në janar 2024, SCiDEV prezantoi komentet e saj lidhur me Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. SCiDEV vëren se masat janë përgjithësisht të karakterit deklarativ, jo specifike dhe të paqarta, gjë që mund të ndikojë në mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të tyre. SCiDEV rithekson sërish rëndësinë jetike të një procesi konsultimi transparent dhe gjithëpërfshirës përmes tryezave të dialogut të strukturuar si Platforma e Partneritetit të Integritit Evropian, Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian, tryezave të posaçme të diskutimit dhe forumeve të organizuara në bashkëpunim me aktorët përkatës të mediave, shoqërinë civile, organizatat e medias, ekspertë, institucionet e pavarura dhe qarqet akademike me qëllim konsultimin e udhërrëfyesit për funksionimin e demokracisë.

## Rekomandime

### 3.1 Sfidat strukturore

- Sektori i pavarur dhe pluralist i medias është një nga bazat kryesore të një sistemi demokratik që ndërtohet mbi shtetin e së drejtës. Autoritetet shqiptare duhet të angazhohen për të krijuar një mjedis të favorshëm për gazetarët dhe profesionistët e medias, duke u bërë të mundur atyre të veprojnë si mbikëqyrës publikë dhe t'u kërkojnë llogari vendimmarrësve. Aktorët politikë dhe ekonomikë duhet të shmangin ndërhyrjet e panevojshme në sektorin e medias dhe autoritetet publike duhet të shtojnë përpjekjet për të promovuar pluralizmin mediatik.
- 
- Për këtë qëllim, u bëjmë thirrje autoriteteve shqiptare:
- Të nxisin dhe promovojnë një treg mediatik në sa më pak duar duke miratuar dhe zbatuar legjislacionin e nevojshëm kundër një përqendrimi të tillë të mediave;
- Të respektojnë pavarësinë e të gjitha mediave dhe të shmangin çdo formë ndërhyrjeje politike ose financiare në politikat editoriale për qëllime propagandistike;
- Të promovojnë qartësinë dhe transparencën e pronësisë së mediave duke përmirësuar funksionimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit në mënyrë që ajo të ofrojë informacion të përditësuar, transparent dhe gjithëpërfshirës për pronarët e mediave për të shmangur kështu rrezikun e kapjes së mediave nga pushtetet politike dhe ekonomike që mund të ndërhyjnë në vendimet editoriale që kanë si synim heshtjen e zërave kritikë.

### 3.2 Cilësia e mediave në përgjithësi

- Gazetaria cilësore është me rëndësi të jashtëzakonshme që garanton të drejtën e qytetarëve për informim. Prandaj, është në interesin e

përgjithshëm të shoqërisë shqiptare përmirësimi i cilësisë së sektorit të medias.

- Në këtë drejtim, u bëjmë thirrje autoriteteve shqiptare:
- Të njohin publikisht rolin kyç të medias për një shoqëri të qëndrueshme demokratike, duke siguruar kushte të përshtatshme pune për të gjithë gazetarët dhe profesionistët e mediave;
- Të nxisin gazetarinë investigative duke treguar mbështetje publike për funksionin e saj në mbulimin e çështjeve me interes publik dhe duke vepruar si mbikëqyrës publik mbi pushtetin politik dhe atë ekonomik;
- Të shmangin çdo përpjekje për ushtrim kontrolli mbi organet e medias për qëllime propagandistike ose personale dhe të dënojnë publikisht përdorimin e mediave për qëllime shantazhi.

### *3.3 Siguria e gazetarëve*

- o Edhe pse në Shqipëri është regjistruar një numër relativisht i ulët i sulmeve kundër gazetarëve, mungesa e informacionit gjithëpërfshirës mund t'i bëjë vendimmarrësit të nënvlerësojnë problemin që lidhet me sigurinë e gazetarëve.
- o Për të ndrequr këtë situatë, u bëjmë thirrje autoriteteve shqiptare:
- o Të vënë në zbatim një sistem efikas monitorimi për mbledhjen e informacionit mbi sulmet ndaj gazetarëve, përfshirë këtu informacione për sulmet që kanë ndodhur në vitin/vitet e kaluara, duke miratuar një sërë protokollesh sistematike dhe të institucionalizuara për mbledhjen e të dhënave. Ky informacion duhet të vihet në dispozicion të publikut menjëherë për të bërë të mundur shqyrtimin prej tij.
- o Të marrin masa të posaçme për trajtimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe frikësimeve kundër grave. Të dhënat për dhunën ndaj grave duhet të jenë të ndara. Autoritetet publike duhet të promovojnë krijimin e kanaleve të posaçme ku gratë gazetare të denoncojnë rastet e dhunës ose ngacmimit.
- o Të ndryshohet Kodi Penal për të parashikuar mbrojtje të posaçme për gazetarët në rast sulmesh ndaj tyre, duke siguruar që prokurorët t'i japin përparësi rasteve të tilla në të njëjtën mënyrë si në vendet e tjera të rajonit. Po ashtu, ata duhet t'i ndjekin këto çështje më tej me autoritetet kompetente në vend



për të siguruar efektivitetin e masave të marra dhe zbatimin e legjislacionit.

- o Të informohet gjerësisht publiku për rezultatin e rasteve të dhunës kundër gazetarëve për të dërguar një mesazh të qartë me qëllim dekurajimin e dhunës dhe për t'i nxitur gazetarët t'i denoncojnë rastet tek autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit.
- o Të ofrohen fonde dhe trajnim i nevojshëm për agjencitë e zbatimit të ligjit për rritjen e kapaciteteve të tyre në trajtimin e rasteve të shkeljeve të lirisë së medias dhe sulmeve kundër gazetarëve;
- o Të zhvillohen kapacitetet për hetimin e kërcënimeve në internet dhe për pajisjen e agjencive të zbatimit të ligjit me burimet e nevojshme për trajtimin e rasteve të sigurisë kibernetike;
- o Të mbështeten gazetarët duke marrë masa konkrete, të tilla si:
  - o Përshtatja e skemave ekzistuese të mbrojtjes së viktimave sipas nevojave të gazetarëve në një mënyrë që të jetë në përputhje me profesionin e tyre;
- o Krijimi i mekanizmave të posaçëm për sigurimin e masave mbrojtëse në rastet e kërcënimit të gazetarëve, përfshirë këtu edhe mundësinë e kërkesës për qëndrim jashtë vendit;
- o Krijimi i një qendre për ndihmë juridike të specializuar dhe falas në ndihmë të gazetarëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për përballimin e sfidave ligjore. Qendra të tilla duhet të kenë burimet e nevojshme të pavarura nga financimi shtetëror.
- o Të ndërmerret një qasje proaktive për trajtimin e problemeve të sigurisë që lindin si pasojë e kushteve të këqija të punës dhe nga mosrespektimi i të drejtave në punë. Në mënyrë të veçantë:
  - o Të sigurohet respektimi dhe zbatimi rigoroz i Kodit të Punës;
  - o Të ndiqen deri në fund ankesat e gazetarëve që bëhen tek Inspektorati i Punës;
- o Të kuptohet serioziteti i sfidave specifike gjinore në sektorin e medias, të merren masa të posaçme për gratë gazetare dhe të mblidhen të dhëna të ndara për të evidentuar informacionin specifik mbi diskriminimin, përfshirë këtu diskriminimin sipas grupeve (d.m.th., gratë e reja gazetare), ku preken gratë.

### *3.4 Aksesi në informacion*

- Kuadri ligjor për të drejtën e informimit në Shqipëri duhet të përmirësohet. Autoritetet shqiptare duhet:
- Të japin një përkufizim sa më të qartë për interesin publik në përputhje me standardet që aplikohen në Evropë. Përkufizimi aktual është me të vërtetë shumë i përgjithshëm dhe u jep autoriteteve liri të pakufizuar interpretimi;
- Të tregojnë një angazhim të qartë për mbrojtjen e të drejtës për informim, duke zbatuar në mënyrë rigoroz Ligjin “Për të drejtën e informimit”, duke respektuar afatet dhe duke ofruar informacion të qartë dhe transparent kur refuzojnë kërkesat për informacion;
- Të verifikojnë nevojën për rregullore mbi akreditimin e mediave dhe të sigurohen që rregullore të tilla të mos kufizojnë në mënyrë të panevojshme aftësinë e gazetarëve për të marrë informacion dhe t’u bëjnë të mundur atyre të bëjnë punën e tyre siç duhet.

### *3.5 Paditë gjyqësore kundër gazetarëve*

- Paditë gjyqësore kundër gazetarëve janë në rritje. Autoritetet shqiptare duhet:
- Të krijojnë një regjistër të posaçëm për këto lloj padish, duke kërkuar vazhdimisht dhe sa më shpesh informacione nga të gjitha gjykatat në vend, dhe ta fusin këtë informacion menjëherë në një bazë të dhënash;
- Të harmonizojnë legjislacionin shqiptar me direktivat e miratuara së fundi nga BE kundër padive SLAPP dhe me rekomandimet përkatëse të Këshillit të Evropës;
- Të angazhohen në një reformë të besueshme për regjimin e shpifjes në vend, ku të miratohet një legjislacion që e dekriminalizon atë.

### *3.6 Fushatat e shpifjes*

- Autoritetet shqiptare duhet të ndërgjegjësohen për ndikimin negativ të fushatave shpifëse mbi gazetarinë e lirë. Për këto arsye, ato duhet:
- Të ushtrojnë vetëpërmbytje dhe të shmangin nisjen e fushatave shpifëse si dhe të deklarojnë publikisht mbështetjen e tyre për gazetarinë e lirë dhe të pavarur dhe nxisin partitë politike të ushtrojnë të njëjtën vetëpërmbytje;

- Të mbështetin krijimin e një qendre për mbështetje psikologjike për gazetarët që bëhen objekt i fushatave të shpifjes dhe padive;
- T'u japin një publicitet të gjerë çdo reagimi të institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, si Avokati i Popullit ose Komisioneri Kundër Diskriminimit për çdo raport që mund të publikojnë për këtë çështje.

### *3.7 Udhërrëfyesit për anëtarësimin në BE*

Për sa i përket ekzistencës së udhërrëfyesve për funksionimin e institucioneve demokratike, autoritetet shqiptare duhet:

- Të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile me mirëbesim për zbatimin e masave të parashikuara në udhërrëfyes;
- Të organizojnë një proces të mirëfilltë konsultimi me shoqërinë civile;
- Të bëjnë të mundur transparencën dhe shqyrtimin nga aktorët e shoqërisë civile të ecurisë dhe progresit në zbatimin e udhërrëfyesve.

Së fundi, i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian që të ketë si përparësi mbrojtjen e lirisë së medias në negociatat e anëtarësimin, duke evidentuar se sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave janë sulme të drejtpërdrejta kundër demokracisë. Krahas dialogut me autoritetet kombëtare, institucionet e BE-së duhet të forcojnë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe shoqatat e gazetarëve, duke njohur rolin e tyre si vëzhgues të besueshëm të pushtetit politik dhe bashkëbisedues kompetentë për zbatimin e procesit të reformave.

Raporti hije dhe rekomandimet e tij janë prodhuar si pjesë e Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Mediave (Media Freedom Rapid Response), një mekanizëm mbarëevropian që gjurmon, monitoron dhe u përgjigjet shkeljeve të lirisë së shtypit dhe medias në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet candidate. Ai mbështetet edhe në veprimtari kërkimore dhe advokuese të mbështetura nga Projekti “Advokacia Ndërkombëtare për Lirinë e Informimit në Ballkanin Perëndimor (Transnational Advocacy for Freedom of Information in the Western Balkans - ATLIB”, bashkëfinancuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë, gjithsesi, vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti i grantit nuk mund të jenë përgjegjës për pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu.

